

Kushtet e Përdorimit

Përdorimi i kësaj faqeje

Kjo faqe është e kontrolluar dhe operohet nga HRA Pharma, zyrat qendrore të së cilës gjenden në 15, rue Béranger, 75003 PARIS, France (telefon: + 33 (0) 1 40 33 11 30). Hyrja dhe përdorimi i kësaj faqeje janë subjekt i këtyre Kushteve të Përdorimit dhe të gjithë ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme. Duke hyrë dhe përdorur këtë faqe, ju pranoni, pa asnjë limitim ose kualifikim, këto Kushte Përdorimi.

HRA Pharma ruan të drejtat të ndryshojë këto Kushte Përdorimi herë pas here, pa njoftuar, si ta shohë të nevojshme; kështu, ju jeni të këshilluar t'i kontrolloni rregullisht.

Kjo faqe është publikisht e disponueshme.

Kjo faqe nuk ka për qëllim të përdoret si burim i këshillave ose mendimeve mjekësore. Të dhënat e ofruara në këtë faqe, në asnjë rrethanë nuk duhet të përdoren për të përcaktuar një diagnozë mjekësore, e cila mund të arrihet vetëm duke u konsultuar me një mjek të kualifikuar.

Përmbajtja dhe Detyrimet

Kjo faqe është krijuar për të ofruar informacione të përgjithshme mbi kontraktivët e urgjencës dhe ato normalë dhe informacione specifike mbi kontracëpsionin tonë të urgjencës ellaone®, që ka në përbërje 30 mg ulipristal acetat. Ai është zhvilluar në dakordësi me parimet e rregulloreve ndërkombëtare. It has been developed in accordance with the principles of international regulations.

Ju bini dakord që aksesit dhe përdorimi i kësaj faqeje, si dhe përmbajtja në të, është përgjegjësia juaj. HRA Pharma dhe palët e përfshira në krijimin, prodhimin dhe shpërndarjen e kësaj faqeje qartësisht përjashtojnë:

- Të gjitha kushtet, garancitë ose termat e tjera që mund të jenë përfshirë nga statute, ligje të zakonshme ose nga ligji i barazisë.
- Ndonjë detyrim për ndonjë humbje ose dëmtim direkt, indirekt ose që vjen si pasojë e aksesit në këtë faqe, mundësisë ose pamundësisë për të përdorur këtë faqe ose ndonjë gabimi ose heqjeje në përmbajtje.

HRA Pharma nuk pranon asnjë detyrim nga humbjet ose dëmtimet e shkaktuara nga sulme të mohimit të shërbimit, viruset ose materiale të tjera të teknologjikisht të dëmshme, që mund të infektojnë pajisjet kompjuterike tuaja, programet kompjuterike, të dhënat ose materialet e tjera në pronësi për shkak të përdorimit të të dhënave audio, video ose tekst në këtë faqe ose në ndonjë prej aspekteve të tjera të kësaj faqeje.

Regjistrimi dhe Privatësia

HRA Pharma respekton privatësinë e përdoruesëve të regjistruar të faqes dhe përdoruesit duhet t'i referohen Politikës së Privatësisë për të dhënat lidhur me mbledhjen dhe përdorimin e informacioneve tuaja personale.

Markat e Regjistruara dhe Logot

Nuk mund të përdorni në asnjë mënyrë markat e regjistruara dhe logot e përdorura në këtë faqe.

Të drejtat e Autorit

HRA Pharma është pronari ose liçenuesi i të gjitha të drejtave të autorit në këtë faqe. Këto të drejta janë të rezervuara. Ju mund të shkarkoni dhe të mbani në disk ose si kopje fizike nga një kopje e vetme e materialit të publikuar në këtë faqe për përdorimin tuaj personal, jo-komercial, me kusht që të mos hiqni njoftimet e të drejtës së autorit ose të pronësisë. Ju nuk mund të kopjoni, shpërndani, shfaqni, shkarkoni, modifikoni, ripostoni, transmetoni ose përdorni pjesërisht apo plotësisht materialet pa lejen me shkrim, marrë paraprakisht nga HRA Pharma. Ju nuk mund të pasqyroni në një server tjetër uebi të gjithë ose një pjesë të materialit të publikuar nga HRA Pharma në këtë faqe dhe nuk mund të kopjoni asnjë nga grafikat që ndodhen në ndonjë prej materialeve të publikuara në këtë faqe.

Asnjë informacion i përmbajtur këtu nuk do të interpretohet përmes nënkuptimeve, pengesave ose ndonjë liçence ose të drejte nën patentën ose markën e regjistruar të HRA Pharma, ose ndonjë palë të tretë. Përveçse si është shprehur gjerësisht më sipër, asnjë përmbajtje e kësaj faqeje nuk do të interpretohet si liçensë ose e drejtë ndaj ndonjë të drejte autori, për të cilën HRA Pharma është pronar ose liçensues.

Sajtet e Palëve të Treta dhe Lidhjet në Sajtet e Tjera

Ky sajt mund të përdoret si një portal për sajtet e tjera të lidhura me kontracepsionin e urgjencës dhe trajtimet e kontracepsionit të urgjencës nga HRA Pharma. Megjithatë, lidhjet (links) ose referencat në sajtet e tjera të mirëmbajtura nga palë të treta, mbi të cilët HRA Pharma nuk ka kontroll, ofrohen vetëm si një lehtësi. Në mënyrë të ngjashme, ky sajt mund të aksesohet nga lidhje të palëve të treta, mbi të cilat HRA Pharma nuk ka kontroll. HRA Pharma nuk jep garanci apo bën përfaqësime lidhur me saktësinë, përdorimin ose plotësinë e ndonjërit prej informacioneve të gjendur në këto sajte dhe nuk do të ketë asnjë detyrim për humbje apo dëmtim të çdo lloji, që mund të vijë nga përdorimi i përmbajtjeve ose informacioneve të tilla. Përfshirja e çfarëdo lloj lidhjeje nga një palë e tretë nuk nënkupton miratimin apo rekomandimin nga HRA Pharma.

Rezervimi i të Drejtave

HRA Pharma rezervon të drejtat të ndryshojë ose të fshijë material nga kjo faqe në çfarëdo moment, pa lajmërim.

Ligjet në Fuqi

Ligjet franceze qeverisin këto Kushte Përdorimi dhe interpretimin e tyre, dhe gjykatat franceze do të kenë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çfarëdo konflikti që mund të ngrihet prej ose në lidhje me këto Terma Përdorimi.

Të Ndryshme

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre Termave të Përdorimit mbahet si e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të shkëputet pa prekur validitetin, ligjshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të mbetura. Përveçse siç është shprehur gjerësisht, këto Kushte Përdorimi përbëjnë gjithë marrëveshjen midis jush dhe HRA Pharma, lidhur me përdorimin e këtij sajti dhe përbërjes së tij.